



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS  
OSNOVNI SUD U MITROVICU - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.459/2015

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, (e vendosur në objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si gjykatë kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Naim Mehulli, në çështjen juridike të paditësit: nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. nga Mitrovica kundër të paditurit ish nga Mitrovica tani me vendbanim të panjohur të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Av. për vërtetimin pronësie, pas mbajtjes së seancës kryesore në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe përfaqësuesit të të paditurit të datës: 15.02.2017, me datën 06.03.2017 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses në tërësi si e BAZUAR dhe
- II. **VËRTETOHET** se paditësi: nga Mitrovica është pronar në bazë të mbajtjes me mirëbesim për më tepër se 20 vite i sipërfaqes prej 304 m2 oborr dhe 136 m2 shtëpi ndërtese, pjesë e ngastrës kadastrale nr. ZK Zhabar i Poshtëm,
- III. **OBLIGOHET** i paditurit që në afat 15 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykim të drejtën e specifikuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'ia njehin paditësit si dhe të njëjtit t'ia lejojë regjistrimin e kësaj të drejtë në regjistrat kadastral, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërbej të njëjtit si bazë për regjistrim në regjistrat përkatës kadastral.
- IV. **OBLIGOHET** paditësi që përfaqësuesit të përkohshëm Av. në emër të përfaqësimeve të i'a paguaj shumën prej 270 euro, ndërsa gjykatës në emër të përpilimit të këtij aktgjykimi shumën prej 25 euro të gjitha në afat 15 ditor nën kërcënimin e përmbarimit.

## Arsyetim

Paditësi me anë të padisë dhe në deklaratimet e të autorizuarit të saj në seanca gjyqësore kërkoj nga gjykata që të vërtetohet se paditësja është pronare mbi bazën e shitblerjes dhe mbajtjes me mirëbesim për më tepër se 20 vite i natuajtshmërisë pjesë e ngastrës P-  
ZK në

Meqenëse të paditurit nuk i dihej vendbanimi, gjykata duke vepruar konform propozimit të të autorizuarit të paditësit e pas shterjes së mjeteve rreth sigurimit të adresës eventuale të të paditurit, të njëjtit ia ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit të parë në seancë kryesore dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë, çështjen e vendosjes ja lë Gjykatës. Shpenzimet e procedurës i kërkoj.

Në fjalë përfundimtare i autorizuari i paditëse deklaroi se nga provat e nxjerra në mënyrë të pa kontestueshme u vërtetua bazushmeria e kërkesëpadisë andaj gjykatës i propozoi që të njëjtën ta aprovoi në tersi dhe të bëjë aktgjykim me të cilin vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale të cekur në shkresë të lëndës, në bazë të kontratës gojore dhe mbajtjes me mirëbesim me gjatë se 20 vite si dhe neni 73 të LMD me të cilin parashihet se për kontratën për të cilën është e domosdoshme forma e shkruarë e paraparë ligjore e nëse nuk është lidhur në këtë formë ndërsa është përmbushur në pjesën me të madhe ose në tersi kjo kontratë konsiderohet valide dhe prodhon efekt juridik, andaj paditësi konform normave të cekura e ka fituar të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale si në fletën poseduese dhe ekspertizën e ekspertit gjeodet në masë dhe kufij të cekur në këto dy akte. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Në seancë kryesore gjykata dëgjoi dëshmitarët:

dhe

Me qëllim të vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike gjykata administroi këto prova: ekspertiza gjeodete e dt.23.12.2016 bashkë me kopjen e planit dhe skicën e terrenit të parcelës kontestuese, certifikata e pronësisë me nr. të njësisë P- e datës së lëshimit 15.07.2015, certifikata e pronësisë me nr. të njësisë P- e datës së lëshimit 23.12.2016, informata e policisë 04/1- datës 05.08.2016 dhe shpallja në gazet datës 19.09.2016.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe të gjitha së bashku konform dispozitave ligjore, dhe pas kësaj erdhi në këto përfundime:



Nuk është kontestuese se paditësi pjesën e ngastrës kontestuese e ka në posedim, pasi këtë fakt gjykata e vërtetoi në momentin e daljes në teren, e po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga ekspertiza gjeodete.

Nuk është kontestuese se ngastra në tërësi evidentohet në emër të të paditurit, ky fakt vërtetohet në bazë të certifikatës së pronësisë.

Sa i përket çështjes së shitblerjes dhe periudhës së mbajtjes, e po ashtu edhe mirëbesimit në mbajtje, në mungesë të provave tjera për të dëshmuar këtë fakt gjykata u bazua në deklarin e dëshmitarëve, të cilët deklaratat e tyre ia dhanë nën betim.

Dëshmitari deklaroi se unë e di se paditësi diku në vitin 2008 e ka blerë shtëpinë se bashku me oborr prej një serbi të cilit emrin nuk ja di për çmimin pesë mijë dinar ku ka qene prezent në momentin kur ja ka dhanë shumën e lartcekur për sipërfaqen prej 4 ari e diçka, është vendosur menjëherë në at shtëpi, sa e di unë askush nuk e ka penguar në shfrytëzim.

Ndërsa dëshmitari deklaroi se paditësi e ka blerë shtëpinë në vitin 2008 se bashku me oborr për çmimin katërqind- pesëqind mijë dinar, i njëjti është vendosur në këtë shtëpi menjëherë, e kam njohur të paditurin pasi që vetëm një shtëpi na ka ndarë prej tina, shpesh jam përshëndetur, i njëjti pasi e ka shtir shtëpinë është larguar nga aty dhe nuk e di se ku gjendet, me sa e di askush nuk e ka penguar në shfrytëzim e shtëpisë dhe se i njëjti pa ndërprerë nga vitet 80 e shfrytëzon shtëpinë dhe oborrin e tij.

Dy dëshmitarët nuk janë në lidhje familjare me paditësin, të njëjtit në deklaratat e tyre ishin të sinqertë, dhe ishin në moshë të shtyre.

Deklaratat e këtyre dëshmitarëve rreth blerjes së shtëpisë me oborr po ashtu përputhen edhe me faktin se me rastin e daljes në teren gjykata konstatoi shtëpi një kate me oborr e rrethuar në të gjitha anët, në anën përball shtëpisë mur i gjallë.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata bazohet në Ligjin Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, 28 të këtij Ligji. Mirëpo kjo është drejtë parashihet dhe me nenin 40 të Ligjit për Pronësinë dhe Të Drejtat Tjera Sendore.


Arsyeja e aplikimit të Ligjit të mëhershëm qëndron në faktin se baza juridike e kërkesëpadisë është krijuar në kohën kur në fuqi ka qenë ky ligj.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata u bazua në nenin 454 të LPK-së bazuar edhe në shkaktimin e shpenzimeve me veprime të palëve si dhe suksesit të palëve në procedurë ndërsa për shpenzime gjyqësore u bazua në nenin 10. Pika 12 në lidhje me pikën 1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për unifikimin e taksave Gjyqësore nr.2008/2.

Aktgjykimi u bazua në nenin 143 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
C.nr.459/2015 Datë: 06.03.2017

**GJYQTARI**  
Naim Mehulli



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 dite nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA,

VENDIMI ËSHTË I PLOTËDORSHËM  
ODLUKA JE PRAVNOBNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
MITROVICE - MITROVICA

Më -  
Dana

29 03 2017  
